

P.nr .130/ 2008

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT NË GJILAN**, në trupin e përbërë nga gjykatësi Refik Alili , kryetar , gjykatëses të deleguar të Gjykatës Komonale në Gjilan , Emine Salihu , ndihmësgjykatësit Shaqir Hyseni , Muharrem Rrahmani dhe Miftar Maloku , anëtarë , me sekretaren juridike Fikrete Destani , në lëndën penale kundër të akuzuarit *[Emri i akuzuarit]* nga Vitia , për shkak të veprave penale e atë : vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 7 të KPK , dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK dhe mbajtja në pronësi , në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK dhe të akuzuarve *[Emri i akuzuarit]* dhe *[Emri i akuzuarit]* , që të dy nga fshati Lubisht, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 paragrafi 1 të KPK – lidhur me nenin 23 të KPK , të cilit i mbrojnë *[Emri i mbrojtësit]* , *[Emri i mbrojtësit]* dhe *[Emri i mbrojtësit]* , avokat nga Gjilani dhe *[Emri i mbrojtësit]* , avokat nga Prishtina , sipas aktakuzës të Prokurorisë Publike të Qarkut në Gjilan , PP.nr. 58/2008 dt. 4 korrik 2008 , që e përfaqëson Vaxhid Idrizi , prokuror publik i qarkut , pas mbajtjes të shqyrtimit gjyqësor e publik , më më 14 tetor 2008 , më 15 tetor 2008 , më 22 dhjetor 2008 , më 10 shkurt 2009 , më 17 prill 2009 , më 1 qershor 2009 dhe më 2 qershor 2009, ka marrë dhe në praninë e palëve shpalli këtë

**A K T G J Y K I M**

Të akuzuarit :

1. *[Emri i akuzuarit]* nga Vitla , rruga *[Emri i rrugës]* , postea nr. 25 , pa pseudonim dhe emër të drejtshëm , nga i ati *[Emri i atit]* dhe e ëma *[Emri i ëmës]* - e lindur *[Emri i nënës]* , i lindur më 20 mars 1977 në Viti , shqiptar , shtetas i Republikës të Kosovës , ka të kryer shkollën e mesme – drejtimi ekonomisë , tregtar , i martuar – babai i 2 fëmijëve , i gjendjes së mesme ekonomike

, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë për ndonjë tjetër vepër penale dhe në paraburgim prej 20 mars 2008 e tutje ,

2. **..... nga fshati Lubisht**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm nga i ati Ekrem dhe e ëma Qazime – e lindur Ismajli , i lindur më 5 prill 1980 në fshatin Lubisht - ku dhe jeton , shqiptar , shtetas i Republikës të Kosovës , ka të kryer klasën e 8 të shkollës fillore , bujk , i martuar - babai i 2 fëmijëve , i gjendjes së mesme ekonomike , nuk ndjekej për ndonjë tjetër vepër penale dhe

3. **..... nga fshati Lubisht**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm nga i ati Feri dhe e ëma Arfie – e lindur Lamalari , i lindur më 1 nëntor 1962 në fshatin Lubisht - ku dhe jeton , shqiptar , shtetas i Republikës të Kosovës , ka të kryer klasën e 8 të shkollës fillore , bujk , i martuar - babai i 3 fëmijëve , i gjendjes së mesme ekonomike dhe nuk ndjekej për ndonjë tjetër vepër penale .

## I-

### I akuzuari

### Është fajtor

1.a- Sepse më 18 mars 2008, rreth orës 14.15 ,në rrugën Qerqis Topulli në Viti , në afërsi ku më parë ka qenë i vendosur kampi Amerikan dhe për shkak të një kontesti pronësor lidhur me pronën e një sërbi , me dashje dhe paramendim e ka privuar nga jeta tani të ndjerin **.....** nga fshati Lubisht , në atë mënyrë , që pas një fjalosje në mes familjes Idrizi dhe babait të pandehurit **.....** dhe vllahut të pandehurit **.....** – Selamiut e pasi ka dëgjuar lajmin mbi rrahjen në mes familjes së tij dhe familjes **.....** nga bashkëshortja dhe kumata , duke i thënë se e mbytën babën dhe vllahun , i pandehuri ka marrë armën e tipit Kallashnikov AK-47 dhe disa herë ka shtënë në anëtarët e familjes Idrizi me ç'rast e ka lënduar **.....** dhe **.....** dhe me atë rast i ka plagosur në pjesën e këmbëve dhe ndërkohë ka ardhur edhe **.....** ku edhe ka shtënë në

drejtim të tij dhe me 7 predha e ka goditur të ndjerin në pjesën e përparme të gjoksit dhe në pjesë të tjera të trupit dhe nga plagët e marra i ndjeri ka vdekur në ambulancën e qytetit të Vitisë,

- me çka ka kryer veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafi 7 të KPK ,

1.b- Sepse në të njëjtë ditë , muaj të vitit 2008 , në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend dhe nga i njëjti motiv i pandehuri , me të njëjtën armë të tipit kallashnikov ka shtënë disa herë në drejtim të pandehurve dhe me disa predha i ka goditur të pandehurit në pjesën e poshtme të trupit dhe nga këto goditje të pandehurit kanë pësuar lëndime të rënda trupore në pjesën e ekstremiteteve të poshtme,

- me çka ka kryer dy vepra penale të vrasjes të rëndë në tentativë nga neni 147 paragrafi 1 nënparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK dhe

1.c- Sepse të njëjtën ditë dhe muaj të vitit 2008 , në të njëjtin kohë i pandehuri , më parë pa autorizim ka siguruar , mbajtur dhe bartur me vete armën e zjarhtë të tipit kallashnikov AK -47 , të cilën armë ditën kritike e ka përdorur e pasi që është lajmëruar rasti në organet e policisë arma e njëjtë i sekuestrohet,

-me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi , në kontroll , në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK .

Dhe në bazë të nenit 34,38,64,71 dhe 73 të KPK dhe dispozitës së cituar ligjore , gjykata përcakton , e atë :

Të akuzuarit , për veprën penale nën 1.a- ( vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafi 7 të KPK ), dënimin burgimi në zgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë ) vjet , për veprën penale 1.b- ( vrasje e rëndë në tentativë neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafi 7 të KPK- lidhur me nenin 20 të KPK, të kryer ndaj të dëmtuarit , me dënim burgimi në zgjatje prej 2 (dy ) vjet , për

veprën penale I.b- ( vrasje e rëndë në tentativë neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafi 7 të KPK- lidhur me nenin 20 të KPK, të kryer ndaj të dëmtuarit ) , me dënim burgimi në zgjatje prej 2 (dy) vjet dhe për veprën penale I.c- ( mbajtja në pronësi , në kontroll , në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK), me dënim burgimi në zgjatje prej 1 (një) viti .

Dhe gjykata

### E gjykon

Me dënim unik burgimi në zgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjet) vjet dhe 11 (njëmbëdhjetë) muaj , në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e paraburgimit prej dt prej 20 mars 2008 , deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimit përkatësisht të aktgjykimit P.nr. 130/2008 dt. 2 qershor 2009 .

Detyrohet që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 300 Euro .

Sekuestrohet arma e zjarhtë e tipit kallashnikov AK - 47 .

Familja e tani të ndjerit ; nga fshati Lubisht , për të realizuar kërkesën pasurore – juridike udhëzohet në tërësi në kontestin e rregullt civil .

I dëmtuari nga fshati Lubisht për të realizuar kërkesën pasurore – juridike udhëzohet në tërësi në kontestin e rregullt civil .

-II-

Të akuzuarit dhe

Në bazë të nenit 389 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPPK ,

Refuzohet aktakuza

1. Të pandehurit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ , në të njëjtën ditë dhe muaj të vitit 2008 , në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin motiv e kanë rrafur të dëmtuarin \_\_\_\_\_ . dhe nga kjo rrahje i dëmtuari ka pësuar plagë të lehta trupore në pjesën e kokës , në pjesën e nofullës , buzës dhe në pjesën e veshit ,

-me çka kishin për të kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 paragrafi 1 të KPK – lidhur me nenin 23 të KPK.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan , me aktakuzën PP.nr. 58/2008 dt. 4 korrik 2008, ka akuzuar \_\_\_\_\_ nga Vitia \_\_\_\_\_ , për shkak të veprave penale e atë : vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 7 të KPK , dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK dhe mbajtja në pronësi , në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK dhe të akuzuarit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ , që të dy nga fshati Lubisht, i ka akuzuar , për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 paragrafi 1 të KPK – lidhur me nenin 23 të KPK.

Prokurori publik i qarkut \_\_\_\_\_ , në ditën e parafundit të shqyrtimit gjyqësor përkatësisht me rastin e paraqitjes të fjalës përfundimtare ,kësaj gjykate ia dorëzoi në formë të shkruar aktin - me fjalën përfundimtare të dt. 1 qershor 2009 , ashtu që , në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se bënë ndryshimin dhe plotësimin e aktakuzës aktuale dhe në rreshtin 4 të dispozitivit nën I- të aktakuzës ku flitet për shkak të një kontestit pronësor lidhur me pronën e një sërbi , shton fjalën nga hakmarrja apo nga motivet e ulëta dhe pjesa tjetër e dispozitivit ngel i pandryshuar dhe për këtë bënë edhe kualifikimin e veprave penale e atë : të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK , të cilit ia shton edhe nënparagrafin 9 të KPK dhe për dy veprat penale vrasje të rënda në tentativë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të cilit ia shton edhe nënparagrafin 9 të KPK - lidhur me nenin 20 të KPK . Dhe konsideron se veprimet e të akuzuarit \_\_\_\_\_ i përmbajnë

tiparet e veprave penale e atë : vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 7 dhe 9 të KPK , dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 dhe 9 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK dhe mbajtja në pronësi , në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK , me propozim që i njëjti , për ato vepra penale të shpallet fajtorë dhe të gjykohet sipas kodit penal .

Sa iu përket të akuzuarve dhe , në bazë të nenit 389 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPPK , hoqi dorë ndaj të akuzuarve në fjalë për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 paragrafi 1 të KPK – lidhur me nenin 23 të KPK.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe me vlerësimin e mbrojtjes së të akuzuarit dhe provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor , kjo gjykatë konstatoi : që i akuzuari , në seancën për konfirmim të aktakuzës të dt. 2 shtator 2008 ka mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet . Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 14 tetor 2008 ka pohuar kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet dhe për të njëjtat ka pramuar edhe fajësinë .

I akuzuari në fazën e marrjes në pyetje ka pohuar se veprat penale për të cilat akuzohet i ka kryer në vetëmbrojtje .

Që gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit Ridvan Emërllahu të dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe provat e administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor , pa dyshim ka konstatuar se i akuzuari ka kryer veprat penale vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 7 të KPK , dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK dhe mbajtja në pronësi , në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK dhe për të njëjtat ka gjetur se është edhe përgjegjës penalisht .

Që prokurori publik i qarkut veprimet e të akuzuarit i ka akuzuar si vepra penale e atë : vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 7 dhe 9 të KPK , dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 dhe 9 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK . Pra, kjo gjykatë me rastin e vendosjes mbi

ekzistimin e veprimit inkriminues nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 9 të KPK, këtë kualifikim të veprës të vrasjes së rëndë dhe të dy tentim vrasjeve të rënda nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 9 të KPK – lidhur me neni 20 të KPK, gjykata me rastin e vendosjes nuk e aprovoi qëndrimin e prokurorit publik se i akuzuari në fjalë të njëjtat ti ketë kryer nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motivet të tjera të ulëta. Pra, kjo gjykatë gjeti se veprimet e të akuzuarit

i përmbajnë tiparet e veprës penale siç ka qenë i akuzuar me aktakuzën aktuale përkatësisht se ka kryer veprat penale e atë: vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 7 të KPK dhe dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK. Poashtu, i akuzuari në fjalë ka kryer edhe veprën penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK. Dhe se për veprat e lartcekura është edhe përgjegjës penalisht.

Që familja e tani të ndjerit ka blerë patundshmërinë - ngastrën kadastrave nr. 2219 në sipërfaqe prej 0.13,20 ha arë e klasit të II në vendin e quajtur Piskavica KK - Viti, nga Shotiq nga Vitia. Kontrata është lidhur më 23 janar 2007 dhe e njëjta është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Viti më 24 janar 2007. Dhe pas kryerjes të bartjes të pronësisë, familja arën e përmendur dhe të posa blerë e ka mbjell me kulturën e lashtë. Dhe se në ditën kritike më 18 mars 2008 familja përkatësisht të akuzuarit dhe dëshmitari, me traktorët e tyre, në të cilët kanë pasur plehër artificial, kanë shkuar për të shpërndarë prehrin në arë. Po në të njëjtën ditë dhe orë edhe i dëmtuari e më pas edhe prindi i tij - dëshmitari kanë shkuar te ara për të parë se kush janë ata persona që po qesin plehër në arën e tyre. Dhe me atë rast ka ardhur deri te fjalosja dhe sharja, ashtuqë, ka ardhur deri te rrahja me ç'rast ka marrë lëndime të lehta trupore i dëmtuari. Dhe nga shtëpia ka qenë i njoftuar ose ka dëgjuar zhurmë nga ara e përmendur edhe i akuzuari, i cili ka shkuar brenda në shtëpi, në dhomë, ku nga nën kanapeja ka marrë armën e tipit kallashnikov AK - 47, i cili nga distanca ka shtënë në drejtim të akuzuarve dhe të cilëve u ka shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe më pas pasi nga vetura Taxi ka zbritur edhe tani i ndjeri, edhe në këtë i akuzuari ka gjuajtur nga arma kallashnikov dhe të njëjtin me 7 predha e ka qëlluar në pjesën e

përparme të gjoksit dhe në pjesë të tjera të trupit me ç'rastas i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore nga të cilat i njëjti ka vdekur në ambulancën e qytetit të Vitisë.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 17 prill 2009 ka deklaruar se veprat penale i ka kryer në vetëmbrojtje. Dhe i njëjti, në pyetjet e avokatëve të tij dhe ka shtuar se ditën kritike ka qenë te shtëpia duke i salduar do pjesë të traktorit. Brenda asaj kohe ka dëgjuar një zhurmë të grave dhe të fëmijëve se dikush e ka vrarë të dëmtuarin dhe babën e tij dëshmitarin. Niset për të shkuar te ara dhe pasi i kalon 20 – 30 hapa nga oborri i shtëpisë në drejtim të arës, kthehet te shtëpia e tij, hynë në dhomën e shtëpisë, ku nga nën kanapeja merr armën kallashnikov dhe në karikatorin e të njëjtës e vendos municionin. Del nga shtëpia dhe vazhdon ecjen në drejtim të arës. Kur është afruar nja 50 – 60 metra nga i vllau dhe i ati nga arma ka qitur 3 herë në ajër për ti frikësuar ata 3 persona që e kishin rrahur të dëmtuarin dhe dëshmitarin. Nga ajo distancë e ka pa të përgjakur dhe të shtrirë për toke dhe të atin të palëvizshëm. Që të akuzuarin e ka parë mbi shpinën e të dëmtuarit ndërsa e ka parë se dorën ia kishte vendosë që prapa babës të . Dhe i akuzuari në dorë e ka pasur tërëfurkun ndërsa i akuzuari Ali Riz në dorë e ka pasur shatin, të cilit janë nisur kah ai. Atëherë nga arma ka gjuajtur në drejtim të tokës. Disa herë edhe i ka parë që të dy të akuzuarit dhe i që kanë ra në tokë. Aty për aty së bashku me kunatën e kap për krahu për ta dërguar te shtëpia. Rikthenet për ta marrë edhe babën e vet. Atëherë e ka dëgjuar zhurmën e grave dhe fëmijëve dhe dikush i ka thënë ruaju se dikush po të mbytet. Kur i ka dëgjuar këto fjalë, nga ai person e ka pasur shpinën e kthyer dhe ky njeri ka qenë tani i ndjeri me revole në dorë. Që në atë kohë të njëjtit nuk ia ka ditur as emrin por e ka parë në pozitë në gjunjë dhe revolen të kthyer kah ai nga e cila edhe ka gjuajtur.

Edhe ky ka gjuajtur në drejtim të atij personi – tani të ndjerit i cili çohet në këmbë, bënë disa hapa dhe ndalet në vend. Pastaj shkon te babai i vet, të cilin e ka kopur dhe tërhequr. Që aty e ka parë dhe e vëren që edhe në dorë ka pasur një revole, të cilin e ka pyetur dhe i njëjti përgjigjet se revolen ia ka marrë personit të shtrirë për toke për tia dorëzuar policisë. Pra, personi i shtrirë ka qenë



I dëmtuari ka deklaruar se arën kontestuese, familja e tij e ka blerë nga pronari i komunitetit serb, para lufte dhe të njëjtën parcelë vite me radhë familja e tij e ka punuar. Që ditën kritike te ara në fjalë i ka parë 3 persona duke hedhur plehër artificial. Ka shkuar tek ata, ku edhe ka ardhur deri te fjalosja dhe njëri prej tyre e ka sulmuar me një hekur dhe nga të goditurat ka ra për toke, e ka humbur vetëdijen.

Dëshmitari dëshmoi se familja e tij vite me radhë që e punon dhe janë pronar të arës kontestuese. Se ditën kritike ka shkuar te ara jo për të sulmuar dikënd por për ta ndal djalin e tij nga personat që kanë qenë te ara duke qitur pleh të cilit e kishin sulmuar dhe rrëzuar për toke. Që e ka parë të shtrirë për toke, por nuk e ka parë se kush e ka sulmuar te ara. Që të akuzuarin e ka parë kur i njëjti e ka qu në këmbë si dhe i ka dëgjuar 4-5 krisma nga arma.

Dëshmitari dëshmoi se në momentin kritik ka qenë duke punuar në shitoren e tij dhe nuk ka parë e as dëgjuar se si është zhvilluar ngjarja.

Dëshmitarja dëshmoi se ditën kritike, dikur rreth orës 14.30, pasi dreka nuk ka qenë gati, i shoqi i saj – i dëmtuari ka shkuar te ara për të parë se si është bima e mbjellur. Që kunata ka qenë duke prerë dru në oborrin e shtëpisë dhe në atë kohë ka dëgjuar zhurmë dhe piskamë dhe e njëjta e ka njoftuar për këtë. Ka shkuar në atë drejtim dhe te ara i ka parë 3 persona, duke u përlarë me . Duke shkuar në atë drejtim te shupa e ka parë të akuzuarin me automat në dorë. Distanca ka qenë diku rreth 20 metra që i akuzuari nga automatiku ka qitur 2-3 herë në ajër për ti frikësuar personat e panjohur që ta lëshojnë Selamin dhe . Dhe, ka vazhduar rrugën në drejtim të vendit të ngjarjes. Dhe para saj ka shkuar i akuzuari. Dhe në çastin që është afruar 2-3 metra te ndërsa vetë ka aenë nja 10 metra prapa Selamisë, ka parë që personat e panjohur e kishin liruar dhe janë nisur në drejtim të . Atëherë i akuzuari nga automatiku ka gjuajtur 2-3 herë në drejtim të tokës, me çrast njëri nga personat e panjohur është rrëzuar për toke dhe distanca ka qenë rreth 3 metra. Që e ka kapur për krahu Edhe vetë i ka ndihmuar për ta

quar te shtëpia . Që i akuzuari ka mbetur me i cili ka qenë duke u rrahur me personin tjetër , të familjes . Sa ka qenë duke e qar nga shtëpia , ka vërejtur se nga drejtimi i rrugës ka mbërri vetura Taxi , nga e cila ka dalë një person me revole në dorë , i cili nga e njëjta dy herë ka qitur në drejtim të dhe ka ra në gjunjë . Pastaj personi i panjohur ka gjuajtur edhe 3 herë në drejtim të dhe . Që të shoqin e saj e ka pasur të kapur për krahu dhe më nuk din se çka ka ndodhur në vendin e ngjarjes përpos se e ka dëgjuar edhe 2-3 të shtëna dhe e ka parë personin e panjohur të shtrirë në krahë . Shton se këtë të fundit e ka gjuajtur Ridvan Emërllahu . Vetë largohet nga vendi i ngjarjes . Kur është kthyer te shtëpia të njëjtin e ka parë me revole në dorë .

Dëshmitari dëshmoi se në çastin kur ka dëgjuar krismën e armës ka qenë te shtëpia . Rastin vetë e ka paraqitur në polici . Dhe për rastin njoftohet nga dëshmitari i dhe me veturën e tij të dëmtuarit dhe tani të ndjerin i dërgon te mjeku në Viti .

Dëshmitari dëshmoi se ditën kritike me veturën e tij Taxi , por me kërkesën e të ndjerit , të njëjtin e ka qar deri te vendi i ngjarjes . Me të mbërritur te vendi i ngjarjes , nga vetura tani i ndjeri ka dalë ndërsa vetë largohet me veturë në drejtim të Vitisë . Me të kthyer veturën në rrugë ka dëgjuar një krismë dhe ka qenë i kthyer me shpin kah ai dhe e ka parë të shtrirë Nijazin për toke . Sa ka qenë në largim e sipër ka dëgjuar edhe të shtëna tjera .

Dëshmitari i dëshmoi se sa ka qenë te vendi i ngjarjes e ka parë të akuzuarin me kallash në dorë dhe nga distanca 2-3 metra ka gjuajtur në drejtim të dhe . Poashtu e ka parë kur te vendi i ngjarjes ka mbërri edhe i ndjeri me veturën Taxi , i cili , posa ka dalë nga vetura është nisur në drejtim të arës . Në dorë nuk ka pasur asgjë dhe atëherë ka dëgjuar shumë të shtëna nga kallashi .

Nga kontrata mbi shitblerjen e pasurisë të patundshme , në mes kontraktuesit nga Vitia , në njërën anë si shitës dhe i nga Lubishta , si blerës në anën tjetër , konstatohet se kontrata është lidhur më 23 janar 2007 për numrin kadastral 229 në sipërfaqe prej 0.13.20 ha me kulturë arë e klasit të II . Kontrata e

nënshkruar nga palët kontraktuese dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Viti në numrin Vr.nr. 165/2007 dt. 24 janar 2007.

Nga raporti i autopsisë i dt. 3 prill 2008 vërtetohet se vdekja e tani të ndjerit ka qenë e dhunshme dhe e shkaktuar nga gjakderdhja dhe plagët e marra nga e shtëna e pushkës duke ia dëmtuar organet e brendshme.

Nga mendimi dhe konstatimi i mjekut Dr. M.D. mjek i mjekësisë ligjore konstatohet se të dëmtuarit dhe kanë marrë plagë të rënda nga arma e zjarrit.

Nga të cekurat e mësipërme gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor për veprat penale, e atë: vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 7 të KPK, dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK, sepse veprimet e tij i përmbajnë të gjitha tiparet e veprave penale më përsë afërmi të përshkruara në diapozitivin nën I-a, nën I-b dhe nën I-c, të aktgjykimit dhe për të njëjtat është edhe përgjegjës penalisht.

Gjykata vlerësoi edhe raportin psikik të akuzuarit ndaj veprës penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 7 të KPK dhe ndaj dy veprave penale vrasje të rënda në tentativë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK, të kryera ndaj të dëmtuarve dhe dhe erdhi në përfundim se i akuzuari në fjalë, këto vepra i ka kryer me dashje direkte. Përfundimi i tillë rezultoi edhe nga mbrojtja e të akuzuarit, të dhënë në procedurën paraprake dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku në tërësi ka pranuar kryerjen e veprave penale për të cilat edhe akuzohet. Që pranimin në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka bërë vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë ngase në pyetjet e parashtruara ka deklaruar se e kupton peshën e fjalës pranim, për veprat penale që akuzohet. Dhe, se dashja e tij vërtetohet edhe nga provat e tjera e sidomos dëshmitë e dëshmitarëve, të cilët janë marrë në pyetje në seancat gjyqësore. Dashja direkte e të akuzuarit shifet që nga fillimi, kur nga nën kanapeja e dhomës të shtëpisë së tij ka marrë armën kallashnikov dhe e ka mbushur karikatorin me municion. Dhe nga e njëjta armë, më së pari ka tentuar për ti privuar nga jeta të dëmtuarit dhe

dhe më pas , po nga e njëjta armë me 7 predha e ka qëlluar dhe e ka privuar nga jeta tani të ndjerin .

Deri te ngjarja kritike ka ardhur për shkak arës , të cilën familja Idrizi e ka blerë nga shitësi , më 23 janar 2007 ndërsa familja ka pretenduar se mbi ngastrën kontestuese se është pronar , për të cilën as që ka poseduar dokument valid se është pronar e aq më pak nuk është interesuar që këtë mëdyshje të pronësisë ta sqarojnë as me njerëzit ndërmjetësues e as nëpërmjet gjykatës . Pra, konstatohet vetëm nga fjalët boshe se familja janë pronar , të cilët nuk kanë , për këtë fakt as një mbështetje ose ndonjë provë valide se arën e përmendur ta kenë blerë vite më parë nga pronari .

Gjykata vlerësoi edhe mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë në fazën e shqyrtimit gjyqësor përkatësisht me rastin e marrjes në pyetje të akuzuarin i cili , po në këtë fazë shtoi se veprat penale për të cilat edhe akuzohet i ka kryer në vetëmbrojtje .

Nga vetë pohimi i të akuzuarit rezulton dhe duket qartë dashja e të akuzuarit i cili që nga nën kanapeja e dhomës ka marrë armën kallashnikov dhe e mbushur karikatorin me municion, me të cilën në dorë është nisur dhe ka shkuar deri në vendin e ngjarjes ku edhe i ka kryer veprat penale që akuzohet përkatësisht ka tentuat ti privoi nga jeta të dëmtuarit dhe dhe e ka privuar nga jeta tani të ndjerin .

Edhe pse në këtë çështje penale – juridike janë dëgjuar një mori dëshmitarësh, si të familjes ashtu edhe të familjes . Që askush prej tyre përkatësisht asnjë dëshmitar nuk ka pohuar faktin se i akuzuari ka qenë i sulmuar nga tani i ndjeri ose nga të dëmtuarit dhe . Pra, me asnjë provë nuk u vërtetua pohimi i shprehur i të akuzuarit se veprat penale i ka kryerë në vetëmbrojtje . Dhe , se i akuzuari në këtë mënyrë kërkon që ti shmanget përgjegjësisë penale , por gjykata mbrojtjes së tillë nuk i besoi dhe të njëjtën ia hodhi si të pabazuar ngase pohimi i tij se ka vepruar në vetëmbrojtje nuk ka mbështetje në asnjë provë të administruar në seancat e shqyrtimit gjyqësor , të cilave kjo gjykatë ua fali besimin e plotë .

Nga të cekurat e mësipërme gjykata konsideron se veprimet e të akuzuarit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprave penale e atë : vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 7 të KPK , dy veprave penale të vrasjes të rëndë nga neni 147 paragrafi 1 nëparagrafi 7 të KPK – lidhur me nenin 20 të KPK dhe mbajtja në pronësi , në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK , dhe për të njëjtat është edhe përgjegjës penalisht.

Që gjykata ndaj të akuzuarve dhe për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 paragrafi 1 të KPK – lidhur me nenin 23 të KPK , e refuzoi aktakuzën , për shkak se prokurori publik i qarkut në fjalën përmbyllëse hoqi dorë nga këta të akuzuar dhe po për veprën penale që akuzohen me aktakuzën aktuale , në kuptim të nenit 389 paragrafin 1 nënparagrafin 1 të KPPK.

Me rastin e matjes të dënimit së të akuzuarit , gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 64 të KPPK , që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit . Pra , gjykata ka pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale , shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit në fjalë dhe faktin se me atë rast është privuar nga jeta tani i ndjeri i moshës relativisht të re si dhe kanë marrë lëndime të rënda trupore përkatësisht është tentuar për ti privuar nga jeta të dëmtuarit dhe . Që tani i ndjeri pas vetes ka lënë familjen e ngushtë me shumë anëtarë . Që të dëmtuarit, si familja e tani të ndjerit pastaj familja e të dëmtuarve dhe deri më tash nuk janë pajtuar dhe të njëjtit i bashkohen procedurës penale dhe paraqesin kërkesë për kompensim të dëmit . Të gjitha këto rrethana , kjo gjykatë i konsideron si rrethana rëndonjëse . Si rrethanë lehtësuese , gjykata për të akuzuarin ka pranuar faktin se i njëjti në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 14 tetor 2008 ka pranuar kryerjen e veprave penale , që akuzohet dhe në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësor familjes së dëmtuar i ka shprehur ngushëllime duke thënë se më vjen shumë keq për këtë që ka ndodhur dhe pendohem për veprat e përmendura dhe gjatë seancave , sa edhe ka zgjatur shqyrtimi gjyqësor i njëjti ka pasur sjellje korrekte .

Duke marrë përbazë rrethanat e mësipërme , kjo gjykatë të akuzuarit , ia ka shqiptuar e atë : për veprën penale nën 1 .a- ( vrasja e rëndë nga neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafi 7 të KPK ), dënimin burgimi në zgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë ) vjet, për veprën

penale I.b-( vrasje e rëndë në tentativë neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafi 7 të KPK- lidhur me nenin 20 të KPK, të kryer ndaj të dëmtuarit ) , me dënim burgimi në zgjatje prej 2 (dy) vjet , për veprën penale I.b-( vrasje e rëndë në tentativë neni 147 paragrafi 1 lidhur me nënparagrafi 7 të KPK- lidhur me nenin 20 të KPK, të kryer ndaj të dëmtuarit ) , me dënim burgimi në zgjatje prej 2 (dy) vjet dhe për veprën penale I .c- ( mbajtja në pronësi , në kontroll , në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 1 të KPK), me dënim burgimi në zgjatje prej 1 (një) viti . Dhe në bazë të nenit 71 të KPK ia ka shqiptuar dënimin unik burgimi në zgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet dhe 11 (njëmbëdhjetë ) muaj , e në bazë të nenit 73 të KPK , në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e paraburgimit prej dt prej 20 mars 2008 e tutje .

Sipas bindjes të kësaj gjykate , dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit në zgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë ) vjet e 11 (njëmbëdhjetë ) muaj , është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe ndaj të njëjtit me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 34 të KPK.

Në bazë të nenit 60 të KPK – sekuestrohet arma e zjarhtë e tipit kallashnikov AK - 47 .


Gjykata familjen e tani të ndjerit : dhe të dëmtuarit nga fshati Lubisht , për të realizuar kërkesën pasurore – juridike në tërësi i ka udhëzuar në kontestin e rregullt civil – në kuptim të nenit 112 të KPPK sepse të dhënat e mbledhura në shqyrtimin gjyqësor nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pusorore – juridike .

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 102 të KPPK .


Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimit .

**GJYKATA E QARKUT NË GJILAN**  
dt. 2 qershor 2009


**Sekretare juridike**  
Fikrete Destani, d.v.



**Kryetari i trupit,**  
Refik Alili, d.v.



**Gjykatëse,**  
Emine Salihu d.v.



**E DREJTA NË ANKESË :** Kundër këtij aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij të këtij aktgjykimit.